



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2024:059510

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06227929

P.nr.77/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit F.A. nga Vushtria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.120/23,të datës 27.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së aktgjykimit me datën 25.09.2024, më datë 30.09.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: F.A. nga i ati B..., e ëma Z..., e vajzërisë K..., data e lindjes..., në Vushtri, ku edhe jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer 7 klasë të shkollës fillore, edhe më parë i gjykuar për vepra penale të kësaj natyre dhe të natyrave të tjera.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 15.08.2023, rreth orës 23:10 minuta, në Vushtri në rrugën “Ismajl Qemajli”, pa autorizim, ka poseduar një (1) qese me substancë narkotike e llojit marihuanë, në peshë 15.19 gram, e cila i është gjetur nga policia në xhepin e duksit gjatë planit operativ “Goditja” dhe sekuestruar,

- Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe nenit 269 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: F.A. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dy (2) vjet i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej një mijë e dyqind (1200) euro i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej tri (3) vite.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm nga Policia e Kosovës i substancës narkotike e llojit marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme 15.19 gram, në mbështetje të nenit 269 paragrafi 3 i KPRK-së.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej pesëdhjetë (50) Euro dhe në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën njëzet (20) Euro. Të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzë PP-II.nr.120/23, të datës 27.03.2024, kundër të pandehurit F.A. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.05.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla dhe i pandehuri F.A.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, e njëjta ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin se në afat prej 30 ditësh ata mund të paraqesin, kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 25.09.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, dhe i pandehuri F.A.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 320 të KPPK-se, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë meqenëse pretendon se pesha e substancës narkotike që është gjetur nuk kanë qenë 15.19 gram siç është përshkruar në aktakuzë por kanë qenë 18.3 gram, pasi që edhe ashtu e ka blerë dhe kjo është arsyeja që nuk e pranon fajësinë.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse të shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje ka deklaruar se do të vërtetohet aktakuza e prokurorit të shtetit në raport me të pandehurin F.A. dhe atë në radhë

të parë nga raporti i policit i datës 15.08.2023, që dëshmon se i pandehuri në ditën kritike në xhepin e djathtë të veshjes së tij i është gjetur substanca narkotike, nga vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve po ashtu vërtetohet se nga i pandehuri është sekuestruar substanca në fjalë, ku i njëjti edhe e ka legjitimuar këtë vërtetim me nënshkrimin e tij, ndërsa raporti i ekspertimit nga AKF-ja ka rezultuar se substanca në fjalë në tërësi përfshirë edhe letrën ka vlerën 15.19 gram, ndërsa sa i përket pretendimeve të pandehurit i cili e pranon veprën penale por e konteston sasinë dhe kjo është arsyeja e mos pranimit të fajësisë, lidhur me këtë e njoftojmë të njëjtin që nga formulari i pranimit dorëzimit të provave, nën shenjë 2023-3074 vërtetohet se Policia e Kosovës në AKF e ka dorëzuar dëshminë numër 1 e cila është evidentuar si një qese me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë me peshë 18.3 gram, ku lidhur me këtë çështje është edhe vula e pranimit të këtij institucioni pra AKF-së, e cila e legjitimon këtë sasi që pretendon i njëjti por që pas matjes nga agjencia ka rezultuar se nuk e përmban peshën e njëjtë. Nga të gjitha këto pa asnjë dyshim do të vërtetohet se i njëjti është fajtor për këtë veprë penale dhe atë pa asnjë dyshim do të vërtetohet aktakuza e prokurorit.

Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor u vërtetua se i pandehuri F.A. ka kryer veprën penale që i vie në barë sipas aktakuzës PP.II.nr.120/23, dhe këtë e vërteton raporti i policit Egzon Mehmeti i datës 15.08.2023, që vërteton se të pandehurin në ditën kritike gjatë zhvillimit të një plani operativ e ka ndaluar dhe duke e kontrolluar i është gjetur një sasi e substancës narkotike e që lidhur me këtë substancë në po të njëjtën ditë është përpiluar edhe vërtetimi mbi sekuestrimin e se njëjtën, e cila është nënshkruar nga zyrtari policor dhe nga i pandehuri. Nga raporti i ekspertimit të AKF-së i datës 20.12.2023 vërtetohet se substanca e dyshuar narkotike që përbën objektin e kësaj çështje penale është e llojit marihuanë që përmban substance narkotike si e tillë kjo substance se bashku me një copë të letrës që po ashtu përmban substancë narkotike arrin peshën neto të përgjithshme 15.19 gram. Kjo ka rezultuar pas ekzaminimit dhe matjeve nga AKF-ja ku të njëjtit nga policia e Kosovës me urdhër të prokurorit të shtetit, i është dorëzuar dëshmia e evidentuar se “një qese me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë në peshën prej 18.3gram”.

Lidhur me pretendimet e të pandehurit të dhënë në prokurori dhe sot në seancë i cili e konteston sasinë e substancës të njëjtit edhe në fjalën hyrëse ju qartësua dhe shpjegua kjo mospërputhje e sasisë se dërguar në ekzaminim dhe asaj që ka rezultuar pas ekzaminimit në AKF.

Nga provat e elaboruara u vërtetua pa asnjë mëdyshje e përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri F.A. e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës së kësaj prokurorie, andaj gjykatës i kërkon që të njëjtin ta e shpall fajtor dhe me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh si rrethanë rënduese rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo veprë penale pasi që si te tilla këto vepra penale janë në rritje, e shtuar këtu faktin se si rrethanë rënduese të i merret edhe pesha e substancës ku të njëjtit i është gjetur një sasi prej 15.19 gram, po ashtu si rrethanë rënduese të i merret se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë lehtësuese të i merret gjendja e dobët e ekonomike meqenëse i njëjti është i pa punë.

I pandehuri ne fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbet në tërësi pranë deklaramit të dhënë me rastin e mospranimit të fajësisë.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë shqyrtuar provat si në vijim:

- vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 15.08.2023 me të cilin është konstatuar vendi i sekuestrimit të substancës narkotike që është objekt i kësaj çështje penale, personi të cilit i është gjetur substanca narkotike si dhe sasia e substancës së dyshuar;
- Raporti i ekspertizës së AKF-së me numër të referencës AKF/2023-3074/23-2095 i datës 20.12.2023, me të cilin vërtetohet se substanca e dyshuar narkotike që përbën objektin e kësaj çështje penale është e llojit marihuanë që përmban substance narkotike si e tillë kjo substance se bashku me një copë të letrës që po ashtu përmban substancë narkotike arrin peshën neto të përgjithshme 15.19 gram. Kjo ka rezultuar pas ekzaminimit dhe matjeve nga AKF-ja ku të njëjtit nga policia e Kosovës me urdhër të prokurorit të shtetit, i është dorëzuar dëshmia e evidentuar se “një qese me substancë të dyshuar narkotike e llojit marihuanë në peshën prej 18.3gram
- Nga vështrimi i foto dokumentacionit shihet substanca narkotike të vendosura në peshore për matje.

I pandehuri, në seancën e datës 25.09.2024 ka zgjedhur që të mbrohet në heshtje.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet,

Faktet jokontestuese

- Është fakt jokontestues se i pandehuri në ditën kritike, së është legjitimuar nga zyrtarët policor dhe i është gjetur një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë.
- Është fakt jokontestues se qesja me substancë narkotike e llojit marihuanë e cila është gjetur gjatë legjitimitit, ka qenë e të pandehurit F.A..

Këto fakte nuk janë kontestuar nga palët. Përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj çështje penale.

Faktet kontestuese

- Për gjykatën kontestuese është pesha e substancës narkotike e llojit marihuanë e gjetur gjatë legjitimitit.

I pandehuri lidhur me veprën penale për të cilën ngarkohet nuk e ka pranuar fajësinë, për faktin se i njëjti pretendon se nuk kanë qenë 15.19 gram si është përshkruar në aktakuzë por kanë qenë 18.3 gram sepse edhe kështu e ka blerë.

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjyqimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Nga raporti i oficerit, i datës 15.08.2023 gjykata ka vërtetuar se me datën 15.08.2023, rreth orës 23:10, gjatë planit operativ “Goditja”, duke patrulluar në rrugën “Ismaj Qemajli” kanë hasur në një person dhe atë në F.A.n – të pandehurin ku gjatë kontrollit, në të djathë të gjepit të xhemperit i është hasur substanca e dyshuar narkotike.

- Nga raporti i ekspertimit i datës 20.12.2023 i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka vërtetuar faktin se: Dëshmia #1 e cila ishte qese plastike e tejdukshme që përmban substancë bimore me ngjyrë të gjelbër, me peshë neto 15.19 gram, pas analizimit të së njëjtës ka rezultuar se dëshmia #1 përmban Kanabis (Marihuanë), që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto 15.19 gram, ndërsa sa i përket pretendimeve të pandehurit se substanca e cila i është gjetur ka peshën prej 18.3 gram, pas matjeve të bëra nga AKF-ja në mënyrë profesionale ka rezultuar që substanca marihuan ka peshë neto 15.19 gram;

- Nga procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin F.A., i datës 15.08.2024, gjykata ka vërtetuar se i njëjti ka dhënë deklaratë në polici, ku ndër të tjera ka deklaruar se substancën narkotike e ka marr në Mitrovicë dhe për të e ka paguar vlerën prej 45 euro, ndërsa për peshën e substancës ka deklaruar se nuk e di pasi që nuk e kanë matur, ndërsa sa i përket pyetjeve se a e ka marr këtë substancë për ta e përdorur për vete apo për ta e shitur i njëjti ka deklaruar se e ka marr për të e përdorur pasi që është konsumues i narkotikëve që njëmbëdhjetë (11) vite.

- Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i datës 15.08.2023, gjykata ka vërtetuar se nga i pandehuri është konfiskuar substancë të dyshuar për narkotik në peshë prej 18.3 gram.

- Nga foto dokumentacioni, shihet substanca e dyshuar e vendosur në peshore.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, vepra penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 kryhet nga “*Kushdo që pa autorizim*

posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Sipas vlerësimit të gjykatës, përmes provave të administruara është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë. Pra, gjykata gjatë procedimit gjyqësor ka vërtetuar se i pandehuri ka pasur në posedim substancave narkotike, dhe atë marihuanë me përmbajtje Tetrahidrokanabinol (THC) me peshe neto 15.8 gram, e cila përmbajtje është vërtetuar nga ekspertimi nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar gjendjen e dobët ekonomike të të pandehurit, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka marr rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer nga i pandehur, si rrethanë tjetër rënduese gjykata ka gjetur faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar për vepra të kësaj natyre dhe të natyrave të tjera e cila është vërtetuar nga evidencat penale dhe atë me aktgjykimin P.nr.113/2018 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 07.05.2018, aktgjykimin P.nr.185/2018, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 07.03.2017 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, P.nr.395/2020 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 18.11.2021, P.nr.506/2020 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 27.06.2022, për veprën penal Vjedhja, po ashtu i njëjti është dënuar edhe për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, dhe atë me aktgjykimin P.nr.130/2022 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 17.11.2022.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv do të arrihet qëllimi i dënimit në vështrim me nenin 38 të Kodit Penal të RKS-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe të ngritë moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me konfiskimin, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Urdhrin për konfiskimin e substancës narkotike gjykata e ka marrë konform nenit 269 par.3 të KPRK-së ku është përcaktuar se “Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.”

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.77/24, datë 30.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.